



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. KOSOVO

Planuar / Doretuar Prijemno / Pristato Received / Delivered	10-05	2	vite god. year
Organ / Shërbimi Organ / Shërbimi Org / Unit	SP/MSHEK	2681/2022	112



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.293/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtar dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.293/2022 të datës 28.03.2022 e parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Administrata Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike “*ndërprerje e marrëdhënies së punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 10.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.293/2022 të datës 28.03.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 02.03.2022 ka bërë njoftimin me numër të protokollit 11-06-951 lidhur me lëshimin e vendit të punës dhe me datë 09.03.2022 Zv. Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës nxjerr Vendimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës për ankuesen në vendin e punës “*Zyrtare e Arkave Fiskale*”.

Ankuesja me datë 28.03.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 1628/2022 me pretendim ankimor kundër ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Vendimi i datës 09.03.2022 i Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës; e-mail i datës 15.02.2022; 14.02.2022, 11.02.2022; Formulari për Raportimin dhe Inicimin e Rastit në ZSP e datës 09.08.2019; e-mail i datës 27.09.2021; 15.02.2022; Njoftimi zyrtar mbi zbatimin e vendimeve të Qeverisë 01/055 të datës 21.01.2022 e datës 29.01.2022 dhe i datës 04.02.2022; e-mail i datës 18.02.2022; 08.03.2022 si dhe njoftimi i datës 02.03.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruar nga ankuesja, konstaton se është plotësuar kërkesa ligjore për përfundim të procedimit administrativ



e filluar me ankesën me numër A.nr.293/2022 të datës 28.03.2022 e parashtruar nga ankuesja
sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se më datë 02.03.2022, ankuesja ka parashtruar njoftim me numër protokoll 11-06-95, me të cilën ka njoftuar se ka dhënë dorëheqje/largim nga puna gjegjësisht nga Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa Zv. Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës ka miratuar dorëheqjen e saj dhe me datë 09.03.2022 ka nxjerr Vendim me numër 11/20 mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës për ankueser në vendin e punës "Zyrtare e Arkave Fiskale" nga data 14.03.2022, kurse me datë 28.03.2022 ankuesja ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1628/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këto rrethana, ka konstatuar se meqenëse ankuesja ka dhënë dorëheqje nga puna gjegjësisht nga Administrata Tatimore e Kosovës, atëherë konsideron që objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses është bërë i pamundur apo i kotë sepse me këtë rast nuk ka objekt të shqyrtimit, kështu që në pajtim me dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "**Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë**", andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka bërë përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me ankesën me numër A.nr.293/2022 të datës 28.03.2022 të parashtruar nga ankuesja.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.293/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses.
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

